

QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT Model

Statut i një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 08.01.2024 (data e nënshkrimit të këtij Statuti), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin BMZ SERVICE SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- **Bedri Zaçaj**, i biri i Tetemit dhe Tanës, lindur më 12.12.1988, në rrithin e Mallakastrës, banues në Tiranë, Shqiperi, shtetas shqipetar, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. 038262612 dhe me nr. personal I81212019C leshuar nga Ministria e Puneve të Brendeshme, në date 10.05.2022
- **Marjus Sulkaj**, i biri i Agimit dhe Fatbardhës, lindur më 02.10.1999, në qytetin e Fierit, banues në Tiranë, Shqiperi, shtetas shqipetar, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. 036458395 dhe me nr. personal J91002025P leshuar nga Ministria e Puneve të Brendeshme, në date 25.09.2020
- **Zihni Muçaj**, i biri i Gazmirit dhe Natashës lindur më 09.02.2001, në Vreshtas, Fier dhe banues në Tiranë, Shqiperi, shtetas shqipetar, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. 033457657 dhe me nr. personal K10209019D leshuar nga Ministria e Puneve të Brendeshme, në datë 09.08.2017

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

Sherbime në fushen e teknologjisë së automjeteve.

Import-eksport dhe tregtim te pjeseve te reja dhe te perdonura per automjete Auto servis. Automjete me qira. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete. Tregtim te pasiyeve elektronike. Tregtim goma, bateri, alkol, vajra lubrifikante, antifrise, graso etj. Te gjitha produktet te fushave: IT dhe telekomunikacionit, printerë, kompjutera, UPS, kancelerike dhe tonera, mobilje dhe pajisje per zyra, elektrike, energjetike, hidraulike, mekanike, materiale dhe pajisje elektromjeksore, sisteme te energjise diellore, elektroshtepiake, sisteme te kondicionimit dhe ngohje fitohje e ajrit, ashensore, kaldaja, gjeneratore, kompresore.elektroshtepiake, hidro-sanitare, produkte te pastrimit, materiale te

ndertimit, si dhe te artikujve te tjere te ndryshem. Sherbime ne fushen e turizmit dhe udhetimeve, projektim, ndertim, rikonstruksion lyerje, bojra muri, metalesh ,druri, mirembajtje, mbikqyrje, kolaudim, te veprave civile dhe industriale. Tregti te artikujve te bute per perdonim spitalor, hoteleri, shkolla etj, F.V. te vetratave te ndryshme te xhamit,me profile druri e metalike, dyer dhe dritare druri e metalike te cdo lloji. Tregetim dhe F.V. te portave dhe trareve elektronike.Tregetim te gureve dekorative dhe te tjera te ngashme. Artikuj te kancelarise, letres. Realizim sherbimesh ne fushen gjelberimit, pastrimit te ambienteve te brendeshme dhe te jashteme. Tregtim te artikujve te pastrimit, detergjente, denzifikatanete, etj. Vegla te ndryshme pune. Sherbime karroatreci, tregtim, riparim, mbushje me gaz te kondicionereve te automjeteve, lavazh, lyerje, stukime, drejtime te automjeteve, pike skrapi dhe mbledhje te te gjithe llojeve te metaleve dhe tregtimin e tyre.

Neni 3:
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat (vetëm nëse është e përcaktuar):

Neni 4:
Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:
Tirane Kashar KATUNDI I RI, Rruga Iliria
Km. 7, Godina Nr. 25.

(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nëse ka):

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):
bedrizacaj@gmail.com

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000 (njeqind mijë) Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*).
 - (2) Pjesëmarrrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 1. Ortaku themelues Bedri Zaçaj : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33000 (tridhjete e tre mijë) leke që përben 33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - 2.Ortaku themelues Marjus Sulkaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33000 (tridhjete e tre mijë) leke që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - 3.Ortaku themelues Zihni Muçaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjitheshme 34000 (tridhjete e kater mijë)leke që përben 34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

2

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenhkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkes së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund te detyrojë një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Në te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten masë ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqerie me perqiegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e perqjithshme e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) perfaqësimin e shoqerisë ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

3

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuromi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit: (mbiemrat, emrat, adresat):

- Zihni Muçaj, i biri i Gazmirit dhe Natashës lindur më 09.02.2001, në Vreshtas, Fier dhe banues në Tiranë, Shqiperi, shtetas shqipetar, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. 033457657 dhe me nr. personal K10209019D vendoset administrator i parë i shoqërisë

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:



6

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mënyresim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të

7

ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuari ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshtë njoftuar pezullimi i veprimitarisë ne përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombëtare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërite tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim te rasteve kur eshtë nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrin një vendim per emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, per te caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Përgjithshme te Asamblesë se Ortakëve, ne përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjt 9901 datë 14.04.2012 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K E T

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

Bedri Zaca

Margus Suljaj

Zihni Maçop

* EMERTIMII SHOQERISE*

BMZ SERVICE

Emer mbiemer

(nenshkrimi)